

UNI-Invest sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-17

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë UNI-Invest sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **UNI-Invest sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.(SKK)

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

22 maj 2019



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjakët",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,604,164	270,295
Inventarë	5	815,675,345	378,547,667
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	576,000	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		817,855,509	378,817,962
Aktivitet afatgjatë			
Parapagime dhe investime afatgjatë	7	42,596,539	32,840,869
Aktive afatgjatë materiale	8	919,163	-
Totali i aktiveve afatgjatë		43,515,702	32,840,869
Totali i aktiveve		861,371,211	411,658,831
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	9	207,554,316	279,002,261
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	10	127,326,579	46,413,858
Detyrime tatimore	11	6,696	6,696
Parapagime të arkëtuara	12	528,244,684	87,187,310
Të tjera detyrime	13	484,787	229,104
Totali i detyrimeve afatshkurtra		863,617,062	412,839,229
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		863,617,062	412,839,229
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Humbje të mbartura		(1,280,398)	(177,960)
Humbje të ushtrimit		(1,065,453)	(1,102,438)
Totali i kapitalit	14	(2,245,851)	(1,180,398)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		861,371,211	411,658,831

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	(90,995)	(116,633)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(566,237)	(674,681)
1) Lënda e parë		-	-
2) Të tjera shpenzime	16	(566,237)	(674,681)
Shpenzime të personelit	17	(336,157)	(301,086)
1) Paga dhe shpërblime		(288,000)	(258,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(48,157)	(43,086)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18	(51,287)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(20,777)	(10,038)
Shpenzime financiare		-	-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-	-
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Humbja para tatimit		(1,065,453)	(1,102,438)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Humbja e vitit		(1,065,453)	(1,102,438)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,065,453)	(1,102,438)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

UNI-Invest sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Humbjet e mbartura	Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	100,000	(241,318)	63,358	(77,960)
Humbja e vitit			(1,102,438)	(1,102,438)
Transferim në humbje të mbartura		63,358	(63,358)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	(177,960)	(1,102,438)	(1,108,398)
Humbja e vitit			(1,065,453)	(1,065,453)
Transferim në humbje të mbartura		(1,102,438)	1,102,438	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	(1,280,398)	(1,065,453)	(2,245,851)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Uni-Invest sh.p.k më _____ 2019 dhe janë firmosur si më poshtë:

'Enep, sh.p.k'
Rojmardo Gaj

Hartues i Pasqyrave Financiare



Charles Bouri

Z. Charles Michael Bouri

Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(1,065,453)	(1,102,438)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	51,287	
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		
Rënie/(rritje) në inventarë	(437,127,678)	(344,553,820)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	9,720,459	291,480,112
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(576,000)	-
Rritje/(rënie) në parapagimet e arkëtuara	441,057,374	87,187,310
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	12,059,989	33,011,164
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(970,450)	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	(9,755,670)	(32,840,869)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(10,726,120)	(32,840,869)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,333,869	170,295
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	270,295	100,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,604,164	270,295

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria UNI-Invest sh.p.k është regjistruar pranë QKR me datë 21.04.2011 me NIPT L14026201J. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është prodhimi, import-eksporti dhe shit-blerja me shumicë e çimentos, klinkerit, gëlqeres, argjilës, gipsit, shtufit, mergelit, kuarcit dhe materialeve inerte.

Kapitali i Shoqërisë është 100,000 lekë i ndarë në 2 kuota. 1 kuotë në vlerë 60,000 lekë zotërohet nga Seament Albania dhe 1 kuotë në vlerë 40,000 lekë zotërohet nga A.P Construction.

Administrator i Shoqërisë është Z. Charles Michael Bouri.

Selia qendrore e saj është në adresën : Porti Durrës, Kalata lindore, Godina Seament Albania, Durrës.

Numri i punonjësve në vitin 2018 ishte 1 punonjës. (2017 : 1 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa- mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe më 31 dhjetor 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)***Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyrash	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera AAM	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Aktivët jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

Aktivët e tjera jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	1,604,164	270,295
Në lekë	155,551	123,542
Në monedhë të huaj	1,448,613	146,753
Mjete monetare në arkë	-	-
	1,604,164	270,295

5. Inventarë

Inventarët detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Inventarë	815,675,345	378,547,667
	815,675,345	378,547,667

6. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime për shërbim mbikëqyrje punimesh	576,000	-
	576,000	-

7. Parapagime për investime afatgjata

Parapagimet për investimet afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime për investime afatgjata-Truall	42,596,539	32,840,869
	42,596,539	32,840,869

8. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2017			-
Shtesa			-
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-
Shtesa	599,074	371,376	970,450
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	599,074	371,376	970,450
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2017	-	-	-
Amortizimi i vitit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-
Amortizimi i vitit	24,961	26,326	51,287
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	24,961	26,326	51,287
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	574,113	345,050	919,163

9. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të pagueshme tregtare	207,554,316	279,002,261
	207,554,316	279,002,261

10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrim ndaj Fushë-Kruja Cement Factory sh.p.k	127,326,579	46,413,858
	127,326,579	46,413,858

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	6,696	6,696
	6,696	6,696

12. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagimet e arkëtuara	528,244,684	87,187,310
	528,244,684	87,187,310

13. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime ndaj punonjësve	484,787	229,104
	484,787	229,104

14. Kapitali

Vlera e kapitalit të nënshkruar më 31 dhjetor 2018 është 100,000 lekë i ndarë në 2 kuota. 1 kuotë në vlerë 60,000 lekë zotërohet nga Seament Albania dhe 1 kuotë në vlerë 40,000 lekë zotërohet nga A.P Construction.

Humbja për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2018 është (1,065,453) ALL. (Për vitin 2017: (1,102,438) ALL). Humbja e akumuluar për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2018 është (1,280,398). (Për vitin 2017: (177,960) ALL)

15. Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Humbje nga kursi i këmbimit	(185,535)	(127,392)
Fitim nga kursi i këmbimit	94,540	10,579
	(90,995)	(116,633)

16. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Trajtime teknike	197,604	45,000
Shpenzime marketingu	-	410,675
Komisione bankare	220,354	27,299
Tatime dhe taksa vendore	22,333	-
Shërbime nga të tretë	125,946	191,707
	566,237	674,681

17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për paga	288,000	258,000
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	48,157	43,086
	336,157	301,086

18. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	51,287	-
	51,287	-

19. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera shfrytëzimi paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Gjoba të ndryshme	20,777	10,038
	20,777	10,038

20. Shpenzimi i tatim fitimit

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	(1,065,453)	(1,102,438)
Total shpenzime të panjohura	20,777	10,038
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	20,777	10,038
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>(1,044,676)</u>	<u>(1,092,400)</u>
Humbje fiskale e mbartur	(1,102,438)	(241,318)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<u>(1,065,453)</u>	<u>(1,102,438)</u>

21. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

22. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

www.mazars.al